

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Për ndryshimet ligjore të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Drafti i projektligjit “Për ndryshimet ligjore të ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”” është publikuar në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike më datë 24.05.2022 dhe është mbyllur 24.6.2022, për një periudhë prej 23 ditë pune.

3. Metoda e konsultimit

Në datën 24.6.2022, është mbyllur konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, i projektligjit për disa ndryshime në ligjin 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat”, paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Gjatë fazës që projektligji ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik, pranë adresave të emailit të DPA, konkretisht më adresën e hapur posaçërisht dhe në adresën zyrtare të institucionit, kanë ardhur komente nga aktorë të interesuar.

Me urdhrin e Kryeministrit nr. 13, datë 18.01.2018, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e ndryshimeve të legjislacionit për përmirësimin e punës me dokumentet në Republikën e Shqipërisë”, kryesuar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme, u inicua puna për draftimin e ndryshimeve ligjore.

Bazuar në Urdhërin e DPA nr.281, datë 22.4.2018, “Për krijimin e Grupit të Punës për rishikimin dhe ndryshimin e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, Grupi i Punës, vlerësoi ndryshimet në ligjin “Për Arkivat”, të hartuara në vitin 2018, duke i thjeshtuar ato. Propozimi për ndryshimet ligjore është miratuar në Këshillin e Lartë të Arkivave me Vendimin Nr. 4, datë 16.05.2022

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara janë të gjitha institucione shtetërore, (institucionet e qeverisjes qendore, institucionet e qeverisjes vendore, institucionet e pavarura, agjencitë autonome, ndërmarrjet shtetërore si dhe entet kontraktore).

Projektligji është diskutuar disa herë në Këshillin e Lartë të Arkivave, i cili është organ ndërinstitucional vendimmarrës që miraton strategjitë afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra të zhvillimit të shërbimit arkivor, që kanë të bëjnë me politikën arkivore të shtetit.

KLA-ja përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarët e jashtëm të KLA-së janë përfaqësues të Akademisë së Shkencave, përfaqësues të ministrisë që mbulon çështjet e trashëgimisë kulturore dhe përfaqësues të Universitetit të Tiranës

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsytimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
1. Shfrytëzimi i dokumenteve që ruhen në bazat e të dhënave shtetërore, apo në sistemet elektronike shtetërore.	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet që ruhen në bazat e të dhënave shtetërore, apo në sistemet e të dhënave shtetërore, shfrytëzohen në përputhje me rregullat e këtij ligji. - Dokumentet e krijuara dhe/ose të ngarkuara në sistemin elektronik të projekt-akteve të Këshillit të Ministrave e-akte, që prej fillimit të funksionimit të këtij sistemi, konsiderohen pjesë e dokumentacionit të projekt-aktit. Ky rregull zbatohet për të gjitha dokumentet që janë ngarkuar 	Person Fizik M. Z	I pranuar	Këtë sugjerim Grupi i Punës e pranoi duke e shtuar si pjesë të nenit 61, të Ligjit aktual “Për Arkivat”, pas pikës 2. Pjesa e shfrytëzimit të dokumentit elektronik nuk është e shtjelluar në ligjin aktual “Për Arkivat” dhe do të krijoj mundësi për shfrytëzim të mëtejshëm të këtyre dokumenteve.

	<p>në këtë sistem nga organet kompetente sipas legjislacionit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” duke përfshirë dokumentet elektronike që përmbajnë nënshkrimin elektronik, apo vulën elektronike, dokumentet e tjera në format elektronik që nuk i përmbajnë këto elemente, si dhe dokumentet që ngarkohen si kopje e një dokumenti shkresor (hardcopy) të vlefshëm të krijuar jashtë sistemit.</p> <p>Dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në rast nevoje të arkivimit dhe/ose shpërndarjes e shfrytëzimit në format shkresor (hardcopy) nga të tretë, pas printimit shoqërohen me vulën e institucionit, ose me element të tjerë teknologjikë të autentifikimit si: barcode, kode QR, etj</p>			
--	--	--	--	--

<p>Porpozime për ndryshime në disa nene të caktuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Neni 9, pika 2, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë: e) institucionet arkivore jo publike. ë) arkivat private. - Neni 13, pika 2 ndryshohet si më poshtë: Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor kombëtar, të përshkruar në nenin 9 shkonjat “c”, “ç”, “dh”, “e” dhe “ë”, kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. - Neni 25, pika 1 ndryshohet si më poshtë: Institucionet arkivore jo publike dhe arkivat privatë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licensohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licensim 	<p>Albanian Archives</p>	<p>I refuzuar</p>	<p><i>Këtë sugjerim Grupi i Punës e nuk e pranoi sepse përcaktimi i institucionit arkivor jopublik është term i përcaktuar në ligjin “Për Arkivat”, ku thuhet "Arkiva janë institucionet shtetërore ose joshtetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre”.</i></p> <p>Në këtë kuptim shtimi i termit “Institucione arkivore jo publike” nuk</p>
---	---	--------------------------	-------------------	--

	<p>përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.</p> <p>- Neni 32 ndryshohet si më poshtë:</p> <p>1. Shteti liron nga detyrimet fiskale pronarët e institucioneve arkivore jo publike që zhvillojnë veprimtari kulturore dhe shkencore në kuadër të identifikimit, njohjes dhe vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, në përputhje me ligjin nr. 7892, datë 12.12.1994 “Për sponsorizimet”.</p> <p>2. Shteti liron nga detyrimet vjetore fiskale pronarët arkivave private, që u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në përputhje me ligjin nr. 7892,</p>			<p>është i nevojshëm pasi ligji përcakton se “Arkiva privat” janë institucionet joshtetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore.</p> <p>Rrjedhimisht sugjerimet në lidhje me ndryshimet në nenin 9 pika 2, nenin 13 pika 2 dhe nenin 25 pika 1 nuk pranohen.</p> <p>Për sa i përketë sugjerimit të ndryshimit të nenit 32 ku sugjerohet shtimi i pikës 1 konkretisht “<i>Shteti liron nga detyrimet fiskale pronarët e institucioneve arkivore jo publike që zhvillojnë veprimtari kulturore dhe shkencore në kuadër të identifikimit, njohjes dhe vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, në përputhje me ligjin nr.</i></p>
--	--	--	--	---

	datë 12.12. 1994 “Për sponsorizimet”.			7892, datë 12.12.1994 “Për sponsorizimet”.”, do të linte vend për interpretim nga ana e institucioneve arkivore jo publike dhe rrjedhimisht dhe shmangie nga detyrimet fiskale.
--	---------------------------------------	--	--	---

Shënim: Komentet nga procesi i konsultimit me institucionet shtetërore janë reflektuar në relacion.